



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 526, Datë 24.09.2024

**“PËR MOSFILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT ETIK DHE
PROFESIONAL ME QËLLIM PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT
(GRADIMIN), PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016, PËR
GJYQTAREN {...}”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 24.09.2024, si u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja dhe pasi shqyrtoi propozimin për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...},

VËREN:

I. FAKTET E ÇËSHTJES DHE PROCEDURA E ZHVILLUAR

Në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me shkresën me nr.1692 prot, datë 04.07.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, protokolluar me nr.3527 prot., datë 04.07.2024, është dërguar dosja e gjyqtares {...}, së bashku me aktet e vlerësimit profesional, si dhe vendimin nr.364, datë 02.04.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili është ndryshuar me vendimin nr.45 (JR), datë 26.10.2023 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të dosjes së përcjellë nga organet e rivlerësimit kalimtar dhe dokumentacionit të dosjes personale të gjyqtares, ka rezultuar se:

- znj. {...} është caktuar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me dekretin nr.4313, datë 16.09.2004 të Presidentit të Republikës, detyrë të cilën e ka ushtruar deri në datën 15.09.2010, datë në të cilën është emëruar Inspektore në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me vendimin nr.268, datë 15.09.2010 të ish-KLD-së.
- Me vendimin nr.411, datë 16.12.2013 të ish-Këshilli të Lartë të Drejtësisë gjyqtares i është dhënë pëlqimi për të shërbyer si Avokate e Përgjithshme e Shtetit, në Ministrinë e Drejtësisë, duke konsideruar të mbaruar mandatin e saj si Inspektore pranë Inspektorit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Znj. {...} detyrën e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit e ka ushtruar deri në datën 31.10.2018.

- Me vendimin nr.67, datë 06.02.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, aktualisht Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku vijon të ushtrojë detyrën.

Sa më sipër, për periudhën e vlerësimit tetor 2013-tetor 2016, rezulton se znj. {...} ka ushtuar detyrën:

- (i) Inspektor në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nga muaji tetor 2013 deri në muajin dhjetor 2013, për një kohëzgjatje prej 2 muajsh;
- (ii) Avokat i Përgjithshëm i Shtetit për periudhën dhjetor 2013 deri në datë tetor 2016, për një kohëzgjatje prej 2 vjet e 10 muaj.

Pas konstatimeve si më sipër, KVEVP në mbledhjen e datës 09.07.2024 ka shqyrtuar propozimin e relatores së procedurës së vlerësimit dhe ka vendosur të miratojë propozimin për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}, duke ia kaluar për shqyrtim çështjen Mbledhjes Plenare.

Në datën 20.09.2024, nëpërmjet postës elektronike, gjyqtarës i është njoftuar relacioni mbi projektvendimin “*Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}*”, duke iu njoftuar njëkohësisht: (i) e drejta për të paraqitur kundërshtime/shpjegime me shkrim dhe (ii) e drejta për t’u dëgjuar në Mbledhjen Plenare të Këshillit, duke iu komunikuar data dhe ora e zhvillimit të mbledhjes.

Në datën 20.09.2024, gjyqtarja konfirmoi marrjen dijeni, nuk paraqiti kundërshtime lidhur me relacionin mbi projektvendimin, si dhe nuk kërkoi të dëgjohej në seancë dëgjimore.

II. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

Sa i përket subjekteve të vlerësimit, në nenin 70, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*në vijim Ligji për Statusin*), parashikohet se:

“3. Magjistratët, të cilët janë në skemën e delegimit, ose janë komanduar në Këshilla, Gjykatën e Lartë ose Prokurorinë e Përgjithshme vlerësohen sipas parashikimeve të këtij ligji. Këshillat miratojnë rregulla të detajuara për vlerësimin e magjistratëve në skemën e delegimit ose të komanduar.

4. Magjistratët, të cilët janë komanduar në struktura të tjera dhe ruajnë statusin e magjistratit, vlerësohen sipas sistemit të vlerësimit në strukturën ku janë komanduar”.

Sa i përket periudhës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, në nenin 84, pika 1 dhe 2 të Ligjit për Statusin, parashikohet se: *“1. Magjistrati vlerësohet një herë në tre vjet, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmës magjistrat ose magjistrat i komanduar. 2. Magjistrati vlerësohet një herë në pesë vjet, pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat...”.*

Në vendimin e Këshillit nr. 159, datë 05.04.2023 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, (në vijim vendimit 159/2023) lidhur me periudhën e vlerësimit, në nenin 6, parashikohet se: “1. Periudha e vlerësimit për gjyqtarin e komanduar është e njëjtë me afatin/periudhën e komandimit. Ajo fillon në të njëjtën ditë me komandimin dhe përfundon në fund të komandimit, i cili nuk mund të jetë më shumë se pesë vjet. 2. Këshilli kryen vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit të komanduar pas përfundimit të afatit të komandimit. Si rregull gjyqtari i komanduar vlerësohet vetëm një herë për të gjithë periudhën e komandimit. 3. Nëse gjatë periudhës së komandimit, gjyqtari kandidon për lëvizje paralele ose ngritje në detyrë dhe për të nuk ka vlerësime të kryera apo që mund të kryhen sipas programeve të vlerësimit të miratuara nga Këshilli, ky i fundit bën vlerësim për periudhën e komandimit deri në momentin e kandidimit, vetëm nëse nga vlerësimi i fundit etik dhe profesional, kanë kaluar më shumë se dy vjet. 4. Leja e papaguar e kryer gjatë komandimit, nuk përfshihet në periudhën e vlerësimit. 5. **Periudha e vlerësimit llogaritet në vite kalendarike. Në çdo rast ajo nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit**”.

Në dispozitat kalimtare të vendimit nr.159/2023, në nenin 21, lidhur me gradimin e gjyqtarëve të komanduar në detyrën e inspektorit në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë parashikohet se: “1. Periudha e rivlerësimit kalimtar 08.10.2013 – 08.10.2016 konsiderohet periudhë vlerësimi periodik, i cili përfundon me përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e çdo gjyqtari që në këtë periudhë ka qenë i komanduar në detyrën e inspektorit në ish/Këshillin e Lartë të Drejtësisë. 2. Gradimi i gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit në ish/Këshillin e Lartë të Drejtësisë, kryhet sipas kriterëve dhe aspekteve të vlerësimit, të matura nga treguesit përbërës sipas Metodologjisë së pikëzimit (Lidhja nr.1). 3. Si burime vlerësimi për të përcaktuar nivelin e vlerësimit të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, shërbejnë të gjitha të dhënat që përfshihen në dosjen me aktet e vlerësimit profesional të gjyqtarit, të dërguara nga organet e rivlerësimit kalimtar..... 4. Për gradimin e gjyqtarit të komanduar që ka ushtruar detyrën e inspektorit në ish/Këshillin e Lartë të Drejtësisë, burim vlerësimi për kriterin e “Aftësie Organizative” shërbejnë edhe të dhënat statistikore të përfshira në dosjen e rivlerësimit kalimtar. Gradimi bëhet referuar treguesve sasiorë, kohorë dhe standarteve të përcaktuara në Vendimin nr. 36, datë 29.04.2015 të ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë. 5. Deri në përfundimin e rivlerësimit kalimtar, programi vjetor i vlerësimit etik dhe profesional merr në konsideratë rastet, për të cilat organet e rivlerësimit kalimtar kanë paraqitur në Këshill sipas nenit 171, pika 5 të Ligjit për Statusin, dosjet e me aktet e vlerësimit profesional. 6. Procedura e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarit të komanduar si inspektor, ndjek të njëjtat rregulla të përcaktuara nga nenet 14, 16, 17 dhe 18”.

Neni 97, pika 3 i ligjit 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, parashikon: “Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj.”. Ndërkohë në nenin 41 të Kodit të Procedurave Administrative parashikohet se: “ Procedura administrative fillon kryesisht ose me kërkesë. 2. Fillimi i procedurës kryesisht është në diskrecionin e organit publik. Organi publik është i detyruar të fillojë

procedurën administrative kryesisht kur: a) ligji ose akti nënligjor parashikon fillimin e procedurës; b) situata faktike është e tillë që organi publik duhet të fillojë procedurën administrative për mbrojtjen e interesit publik. 3. Procedura administrative konsiderohet e filluar: a) me kryerjen e çdo veprimi procedural nga organi publik në rastin e procedurës së filluar kryesisht; ose b) me paraqitjen e kërkesës përpara organit publik, në rastin e procedurës së filluar me kërkesë.

III. ANALIZA LIGJORE E ÇËSHTJES

Gradimi i gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për periudhën vlerësimit 2013-2016, mbështetet në përcaktimet e nenit 171, pika 5 të Ligjit për Statusin në të cilin parashikohet se: “5. Pas vlerësimit të aftësive profesionale, të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Apelimit, në rast se është ushtruar e drejta e ankimit, i dërgon Këshillit dosjen me vlerësimin e kryer të magjistratit, çdo dokument të përdorur në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vendimin e formës së prerë të procesit të rivlerësimit. Nëse magjistrati kalon me sukses procesin e rivlerësimit, **Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë gradën e vlerësimit përkatës**”. Në referim të këtij neni, analiza dhe konkluzionet e vendimit të formës së prerë të organeve të rivlerësimit kalimtar, konsiderohen të plota në lidhje me burimet që janë analizuar në kuadër të këtij procesi, vetëm në drejtim të qëllimit të identifikimit të gjyqtarëve që kanë arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Shkalla e kësaj aftësie në nivelet: “Shkëlqyeshëm”, “Shumë mirë”, “Mirë” apo “Mjaftueshëm” përcaktohet në procesin e gradimit, pavarësisht konkluzioneve të organeve të vlerësimit lidhur më të.

Dispozita e mësipërme detyron Këshillin të bëjë gradimin e gjyqtarëve sipas Ligjit Për Statusin, **vetëm nëse në zbatim të ligjit, ky vlerësim është i mundur.**

Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor si më sipër, për znj. {...}, në kushtet kur rezultoi se koha e ushtrimit të detyrës së inspektorit pranë Inspektorit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë që përfshihet në periudhën e vlerësimit 2013-2016, e cila përbën periudhë të plotë vlerësimi, në kuptim të neneve 84 dhe 171/5 të Ligjit për Statusin, është më e shkurtër se një vit, sipas përcaktimeve të nenit 6, pika 5 të vendimit nr. 159, datë 05.04.2023, procedura e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 3 vjeçare që përfshin vitet 2013-2016, nuk mund të fillojë. Ndërkohë për periudhën dhjetor 2013-tetor 2016, gjatë të cilës gjyqtarja ka ushtruar detyrën e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, referuar nenit 70, pika 4 të Ligjit për Statusin, gjyqtarja vlerësohet sipas sistemit të vlerësimit në strukturën ku është komanduar.

Në zbatim të nenit 41 të K.Pr.Administrative që rregullon rastet dhe mënyrën e fillimit të një procedimi administrativ, në lidhje me nenin 171 pika 5 të Ligjit Për Statusin, procedura administrative me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit për gjyqtarët e konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, fillon nga Këshilli në mënyrë të

detyrueshme sipas ligjit, në rast se plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme:

- 1) Gjyqtari të ketë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, duke u konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë;
- 2) Periudha e stazhit profesional pranë Shkollës së Magjistraturës të mos përfshihet në kohën e punës si gjyqtar;
- 3) Koha/periudha e punës si gjyqtar me qëllim gradimi të jetë jo më pak se një vit.

Gjykata Administrative e Apelit, në vendimin nr.86, datë 07.12.2022, vendim i cili ka rrezuar padinë e gjyqtarit G.M, duke pranuar arsyetimin e Këshillit për pamundësinë në objekt e qëllim të procedurës së gradimit të filluar për këtë gjyqtar, ka arsyetuar se: *“.....kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit kalimtar/vetting nga gjyqtari G.M, përbënte rrethanë të pamjaftueshme për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional/vlerësimit periodik, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit/gradimin, përsa kohë që nuk plotësohej edhe një tjetër kusht, ai i përvojës së punës/kohës së ushtrimit të detyrës si gjyqtar, jo më pak se një vit”*. Gjykata e Apelit Administrativ konfirmon qëndrimin e Këshillit se kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit kalimtar/vetting nga një gjyqtar, nuk e bën të pazbatueshme pengesën e parashikuar në nenin 5/4 të Vendimit nr. 263 dt. 21.11.2019 “ Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në rastin konkret, me konstatimin paraprakisht të mungesës së kushteve për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, sipas parashikimeve të nenit 171/5 të Ligjit për Statusin, për gjyqtaren {...}, Këshilli vlerësoi se procedura e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtares për periudhën e vlerësimit 2013-2016, nuk mund të fillonte, në kushtet kur koha e ushtrimit të detyrës së inspektorit pranë Inspektorit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë që përfshihet në periudhën e vlerësimit 2013-2016, e cila përbën periudhë të plotë vlerësimi, në kuptim të neneve 84 dhe 171/5 të Ligjit për Statusin, është më e shkurtër se një vit, sipas përcaktimeve të nenit 6, pika 5 të vendimit nr. 159, datë 05.04.2023, procedura e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 3 vjeçare që përfshin vitet 2013-2016, nuk mund të fillojë. Përcaktimi i këtij kufiri kohor minimal 1 vjeçar, është miratuar nga Këshilli, për të mundësuar kryerjen efektive të vlerësimit me të dhëna dhe materiale të nevojshme për vlerësim (burime vlerësimi).

IV. KONKLUZIONI

Sa më sipër, në kushtet kur gjyqtarja nuk rezulton të ketë ushtruar funksionin e inspektorit pranë Inspektorit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për një kohëzgjatje minimale prej 1 (një) viti brenda periudhës së vlerësimit 2013-2016, procedura e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtares {...} nuk mund të fillojë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 dhe 171 pika 5 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve

dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 61 pika 1, 63 dhe 86 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 41 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, dhe vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 159, datë 05.04.2023 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016.
2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR